REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

**Drejtuar: Operatorit ekonomik "Communication Progress" shpk**
**Adresa:** Tirane Rr. "Stanislav Zuber", Nd. 2, H.I9. Njesia administrative Nr. 7, 1023, Tirane.

# FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

**Procedura e prokurimit: "Kerkese per propozim" "Dixhitalizimi i vlerësimit të performancës".**

**Referenca e procedures:** REF-84869-09-06-2018

**Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: "Dixhitalizimi i vlerësimit të performancës".**

**Fondi limit: 6,396,667 (gjashtë milion e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë)** lekë pa tvsh.

**Burimi i financimit:** vënë në dispozicion në mbështetje të VKB Nr.132,datë 21.12.2017 "Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë Tiranë për Vitin 2018" (i ndryshuar).

**Afati kohor për kryerjen e inplementimit te projektit:** 3 (tre) muaj kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës. Periudha e mirembajtjes së këtij sistemi do të jetë 2 vjet.

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 17.09.2018 ora 12.00**

Publikime të mëparshme, (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini Nr. 36 datë 10 Shtator 2018.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** çmimi më i ulët **X**

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara.

1. **Operatori ekonomik "Communication Progress" shpk**

Open Procurement Albania

**NUIS K01625001C**

Vlera e ofertës – 6,270,000 (gjashtë milion e dyqind e shtatëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.

2. **Operatori ekonomik "Advanced Business Solutions - ABS" shpk**
   NUIS **S'ka**

   S'ka paraqitur oferte

***<u>Janw s'kualifikuar Operatorwt ekonomikw tw mëposhtëm:</u>***

- **Operatori ekonomik "Advanced Business Solutions - ABS" shpk**

***<u>Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:</u>***

- **Operatori ekonomik "Advanced Business Solutions - ABS" shpk**

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria Advanced Business Solutions - ABS nuk ka paraqitur në sistemin elektronik dokumentacionin e plotë ligjor e teknik dhe oferten ekonomike të kërkuar tek kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumenteve të tenderit për këtë procedurë.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave.

Për sa më sipër, Operatori Ekonomik shoqëria Advanced Business Solutions - ABS s'kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor, teknik dhe ekonomik kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", **<u>e shpall të pavlefshme këtë ofertë</u>** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **operatorin ekonomik "Communication Progress" shpk** me adresë: Tirane Rr. "Stanislav Zuber", Nd. 2, H.I9. Njesia administrative Nr. 7, 1023, Tirane se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 6,270,000 (gjashtë milion e dyqind e shtatëdhjetë mijë) lekë pa tvsh, është identifikuar si oferta e suksesshme.

**Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë:** 24.09.2018.

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar) si dhe

në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave

Open Procurement Albania

të prokurimit publik”, pranë Autoritetit Kontraktor,Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.

Open Procurement Albania